

RAPORT

MBI AUDITIMI E PASQYRAVE FINANCIARE

TË SHOQËRISË “ALBKROMI SHA.”

SHOQËRI NË LIKUJDIM E SIPËR

PËR VITIN 2011

Përmbajtja:

1. Raporti i Auditimit i dhënnies të opinionit të sigurisë
2. Pasqyrat Financiare të Audituarra
3. Raport Përmbledhës, Letra e audituesit

RAPORT I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për;
Këshillin Mbikqyrës të Shoqërisë ,
“ALBKROMI” Sh.a. (Shoqëri në Likujdim),
Blloku “Vasil Shanto”
TIRANË

Në përfundim të angazhimit që na keni besuar, kemi nderin tju raportojmë se; Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare, bashkangjitur, të shoqërisë „ ALBKROMI“, sh.a (shoqëri në likujdim e sipër) , për vitin e mbyllur më 31.12.2011, të cilat përfshijnë; 1. Bilancin e llogarive Kontabël , 2. Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve . 3. Pasqyrën e fluksit të parasë, 4. Pasqyrën e ndryshimeve në kapital, 5. Përmbledhje të metodave kontabël të rëndësishme dhe shënimet Shpeguese të P.F.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Shoqëria „ ALBKROMI “ sha dhe ekipi drejtues i saj kanë përgatitur Pasqyrat Financiare për ushtrimin e mbyllur më 31.12.2011. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin : përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve: zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabile: dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jonë si Auditues , është që të shprehim një opinion për këto Pasqyra Financiare bazuar në auditimin e tonë. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit Këto standarte kërkojnë që të zbatohet kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Për të formuar opinionin tonë që po ju raportojmë, jemi bazuar në informacionet, shprehimet dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga shoqëria, përfshirë kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare.

Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe llogjikën e çmuarjeve kontabël të bëra nga Drejtimi, si dhe për vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të Pasqyrave Financiare. Ne në asnjë rast nuk kemi ndërhyrë në procesin e vendim marrjes të kompanisë dhe nuk kemi kontrolluar operacionet tuaja të plota. Punën tonë e kemi bazuar në testet dhe teknikat e nevojshme që kemi gjykuar të mjaftueshme për të paraqitur para ju opinionin tonë të pavarur.

Disa çështje që ndikojnë në dhënien e opinionit të sigurisë.

Audituesit e Pasqyrave financiare të vitit 2010, kanë modifikuar raportin e dhënies së sigurisë në lidhje me çështjet e parashikuara në pikat 1 deri 5 të Raportit.

Ne, konstatuam se gjatë vitit 2011, shoqëria nuk ka ndërmarrë ndonjë operacion financiar të rëndësishëm në lidhje me to. Përveç veçimeve të tyre, ne parashitjmë dhe rekomandojmë shoqërinë që të kryejë;

1. Vlerësimin e pasurisë të saj me vlerën e drejtë.
2. Të provizionohen teresisht kërkesat pa shpresë arkëtimi dhe njohja e tyre në Pasqyrën e të Ardhurave e Shpenzimeve.
3. Ne nuk e kemi vëzhguar inventarin e datës 31.12.2011, meqenëse se kjo datë është përpara angazhimit tonë si auditues të shoqërisë. Për shkak edhe të mënyrës të mbajtjes të rregjistrimeve nuk mundëm , që të arinimin në një përfundim të besueshëm në lidhje me stokun.

Pavarësisht nga paragrafët e mësipërme, ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë përbën baza të mjaftueshme për dhënien e arsyeshme të opinionit të auditimit.

OPINIONI

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve që mund të kenë në të të ardhmen veçimet e mësipërme, Pasqyrat Financiare, japin një pamje të drejtë dhe të sigurtë të gjendjes financiare të Shoqërisë „ALBKROMI“ sh.a. , shoqëri në likujdim e sipër , më dt 31.12.2011, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave, për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar dhe në pajtim me Ligjin 9228/4 „Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“

Çështjet që nuk ndikojnë në opinionin e dhënies së sigurisë.

Gjatë vitit 2011, kapitalet e shoqërisë janë më pak se gjysma e Kapitalit Aksioner. Kjo rënie në vlerë me mbi 58.7% duhet të jetë objekt i rregullimeve dhe plotësimeve në të ardhmen.

AUDITUESIT E PAVARUR

Tiranë, më; 14.05.2012

Kostandin PESHA

Arjeta ÇUMANI



Pasqyrat Financiare te Vitit 2011

Nr	A K T I V E T	Shenime	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
I	AKTIVET AFATSHKURTRA		216,742,020	886,954,828
1	Aktivet monetare	1	25,328,558	25,910,211
2	Derivative dhe aktive te mbajtura per tregtim		0	
3	Aktive te tjera financiare afatshkurtra	2	166,528,609	738,030,890
	> <i>Kliente per mallra,produkte e sherbime</i>		18,321,502	24,839,892
	> <i>Debitore,Kreditore te tjere</i>		137,099,805	702,087,696
	> <i>Instrument ate tjera borxhi</i>		11,107,302	11,103,302
	> <i>Tvsh</i>			
4	Inventari	3	24,884,853	123,013,727
	> <i>Lendet e para</i>		42,327,246	48,185,454
	> <i>Inventari lmet</i>			0
	> <i>Prodhim ne proces</i>			
	> <i>Produkte te gatshme</i>		71,401,420	74,828,273
	> <i>Mallra per rishitje</i>		28,633,850	
	> <i>Parapagesa per furnizime</i>		-117,477,663	
	>			
II	AKTIVET AFATGJATA	4	4,276,954,416	4,357,380,848
1	Investimet financiare afatgjata		4,910,329	5,874,623
2	Aktive afatgjata materiale		12,070,869	367,447,761
	> <i>Toka</i>		68,335,634	68,335,634
	> <i>Ndertesa</i>		43,033,586	87,272,231
	> <i>Makineri dhe paisje</i>		119,306,384	182,365,635
	> <i>Aktive tjera afat gjata materiale</i>		57,310,019	29,474,261
3	Ativet biologjike afatgjata			
4	Aktive afatgjata jo materiale		3,984,058,464	3,984,058,464
5	Kapitali aksioner i pa paguar			
6	Aktive te tjera afatgjata			
	TOTALI AKTIVEVE (I+II)		4,493,696,435	5,244,335,676

Nr	PASIVET DHE KAPITALI	Shenime	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
I	PASIVET AFATSHKURTRA		1,172,156	296,778,280
	1 Derivativet			
	2 Huamarjet			
	3 Huat dhe parapagimet	5	1,172,156	296,778,280
	> <i>Te pagueshme ndaj furnitoreve</i>		922,987	6,958,460
	> <i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>			
	> <i>Detyrime Tatimore& Sigurime Shoq.Shend.</i>			289,532,737
	> <i>Parapagimet e arkëtuara</i>		249,169	287,083
	> <i>Debitore dhe Kreditore te tjere</i>			
	4 Grantet dhe te ardhurat e shtyra			
	5 Provizionet afatshkurtra			
II	PASIVET AFATGJATA	6	2,810,235,593	3,047,478,934
	1 Huat afatgjata			
	> <i>Hua,bono dhe detyrime nga qeraja financiare</i>		63,144,352	63,144,352
	> <i>Bono te konvertueshme</i>			
	2 Huamarje te tjera afatgjata		298,474,233	535,717,574
	3 Grantet dhe te ardhurat e shtyra		106,201,290	106,201,290
	4 Të drejta e detyrime të Konçensionarit		2,342,415,718	2,342,415,718
	TOTALI PASIVEVE (I+II)		2,811,407,749	3,344,257,214
III	KAPITALI	7	1,682,288,686	1,900,078,462
	1 Aksionet e pakices (PF te konsoliduara)			
	2 Kapitali aksionereve te shoq.meme			
	3 Kapitali aksionar		3,405,413,240	3,405,413,240
	4 Primi aksionit			
	5 Njesite ose aksionet e thesarit (Negative)			
	6 Rezervat statutore		1,545,062,358	1,545,062,358
	7 Rezervat ligjore		39,410,111	39,410,111
	8 Rezervat e tjera		25,074,303	25,074,303
	9 Fitimet e pa shperndara		-3,114,881,550	-3,114,881,550
	10 Fitimi (Humbja) e vitit financiar		-217,789,776	0
	TOTALI PASIVEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)		4,493,696,435	5,244,335,676

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve

(Bazuar ne klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyres)

Nr	Perskrimi i Elementeve	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
1	Shitjet neto	13,205,311	9,320,917
2	Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit	21,060,296	0
3	Ndrysh.ne invent.prod.gatshme e prodhimit ne proces	0	2,100,000
4	Materialet e konsumuara	-27,003,569	-25,263,480
5	Kosto e punes	-22,198,467	-20,431,324
	<i>Pagat e personelit</i>	-19,981,672	-17,815,843
	<i>Shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetesore</i>	-2,216,795	-2,615,481
6	Shpenzimet administrative (nentrajtme)	-2,569,805	-1,527,900
6	Amortizimet dhe zhvleresimet	-87,818,955	-110,958,804
7	Shpenzime te tjera		0
8	Totali shpenzimeve (shumat 4 - 7)	-139,590,796	-158,181,508
9	Fitimi (humbja) nga veprimtarite e kryesore (1+2+/-3-8)	-105,325,189	-146,760,591
10	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrolluara	-27,481,172	61,437,825
11	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet	-66,212,274	
12	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare	-18,771,142	5,921,441
	12.1 <i>Te ardh.e shpenz. financ.nga inves.te tjera financ. A.gj</i>	3,700,000	2,500,000
	12.2 <i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat</i>	977,509	3,407,513
	12.3 <i>Fitimet (Humbjet) nga kursi kembimit</i>	366,580	-10,980
	12.4 <i>Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare</i>	-23,815,231	24,908
13	Totali i te Ardhurave dhe Shpenzimeve financiare	-112,464,587	67,359,266
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9 +/- 13)	-217,789,776	-79,401,325
15	Shpenzimet e pa zbritshme		0
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14 - 15)	-217,789,776	-79,401,325
17	Elementet e pasqyrave te konsoliduara		

LETËR E AUDITUESVE TË PAVARUR

RAPORTI PËRMBLEDHËS I AUDITIMIT

Për:

Këshillin Drejtues

Të Shoqërisë „ALBKROMI “ Sh.A.

Shoqëri në Likujdim e Sipër

Të nderuar Zoterinj !

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë Tuaj për Ushtrimin e Mbyllur në Datën 31.12.2011 dhe dhamë opinionin tonë për vërtetësinë e tyre në pajtim me Standartet Kombetare të Raportimit Financiar. Raporti është paraqitur në nivelin më të lartë vendimtarës dhe në nivelin më të lartë të drejtimit ekzekutiv të shoqërisë. Ju, mund ta përdorni atë në veprimtarinë e zakonshme të shoqërisë, për përdoruesit e Pasqyrave financiare

Përveç kësaj, ashtu siç është përcaktuar edhe në letrën tonë të angazhimit, mendojmë se krahas këtij opinionit t'ju komunikojmë edhe disa çështje që kanë dalë gjatë auditimit dhe që mund të paraqesin interes për drejtimin.

Kjo letër ka karakter konfidencial, dhe do të trajtojë çështjet në vijin:

1. Hyrje,
2. Strukturën e kapitalit të shoqërisë dhe organet e saj drejtuese;
3. Kontrollin e Brendshëm;
4. Mbajtjen e kontabilitetit;
5. Përshtatshmëria e politikave kontabël;
6. Mbi trasaksionet dhe pohimet në Pasqyrat Financiare.
7. Rezultati i veprimtarisë;
8. Vlerësime të përgjithshme
9. Të tjera;
10. Vlefshmëria dhe karakteri i letrës.

Kjo letër nuk ka për qëllim të përshkruajë procedurat e ndjekura nga ana jonë në auditim apo përzgjedhjen e tyre.

Kjo letër përmend edhe disa probleme të cilat lidhen me zbatimin e ligjeve të detyrueshme për shoqërinë, por këto probleme përmenden vetëm në zbatim të Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit dhe konkretisht;

Standartin 200, *Objektivi dhe parimet e përgjithshme që drejtojnë auditimin e pasqyrave financiare* dhe Standarti 250, *Marrja në konsideratë e ligjeve dhe rregullave në auditimin e pasqyrave financiare*. Si pasojë, nuk do të shprehim ndonjë opinion apo ndonjë qëndrim lidhur me këto probleme, por thjesht do të përmendim çështjetë cilat mendojmë se duhet të jenë në vëmendje të Drejtimit.

2. Struktura e kapitalit dhe organet e drejtimit

Shoqëria „ALBKROMI“ SH.A. është shoqëri aksionere me pronar te vetëm shtetin, të përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës-shkurt METE-, me kapital themel tër prej 3.405.413.240 lekë, e regjistruar me Vendimin e gjykatës së Tiranës nr 14014, datë 29.02.1996.

Shoqëria është e regjistruar në QKR dhe në administratën tatimore, me numër identifikimi NIPT J61827513H

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë ka qenë nxjerja, pasurim dhe përpunim mineral kromi dhe eksportimi i tij.

Por, me vendimet e regjistruara në Gjykatën e shkallës së parë Tiranë, në me nr 14014/1 deri 14014/4 të viteve 1999, 2000, dhe 2004, si dhe të Urdhrit nr 38, datë 01.03.2004; dhe që është regjistruar në regjistrin tregtar sipas vendimit nr 14014/5, datë 26.03.2004, është vendosur prishja e shoqërisë dhe kalimi i saj në likuidim. Ndaj edhe objekti i veprimtarisë së saj pas kësaj date, si shoqëri në likuidim e sipër, janë trasaksionet e likuidimit të të gjitha aktiveve të shoqërisë.

Shoqëria drejtohet nga Likuidatori i saj. Nga data 16.12.2010 e në vijim Likuidatori i shoqërisë është Z. Faslli Lila. Sipas dispozitave të Ligjit nr 9901, datë 14.4.2008 „Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, likuidatori kryen detyrën e Drejtorit të Përgjithsëm.

Adresa e selisë së shoqërisë është në Tiranë, në bllokun „Vasil Shanto“, pranë Institutit të mjedisit.

Adresa të tjera të shoqërisë; në Durrës, në lagjen „Skënderbej“

Në veçim në lidhje me kapitalin dhe vlerën nominale të tij dhe që nuk ndikon në Opinionin e dhënies së sigurisë dotë shprehemi në vijim tek shënimi 7 i P.F.

1. Mbi kontrollin të brendshëm.

Shoqëria nuk ka njësi të veçantë të kontrollit të brendshëm. Kontrolli i brendshëm që lidhet me funksionet e sistemit kontabël dhe me pohimet e pasqyrave financiare, është realizuar nëpërmjet mbikqyrjes së punëve nga punonjësit e ngarkuar me administrimin dhe nga drejtuesi i shoqërisë.

Sistemi i autorizimeve për kryerjen e trasaksioneve ,blerjet ,shitjet , pagat,hyrjet dhe daljet janë kryer sipas përcaktimeve të vendosura në rregullat staturore dhe ligjore.Unë nuk konstatova raste të shkeljes së tyre.

Shoqëria funksionon në ndarjen e detyrave sipas degëve përbërëse

- Financa
- Shitje dhe privatizim
- Sektori i Përgjithshëm

Unë e konsideroj të rëndësishme strukturën e kontrollit të brendshëm dhe në zhvillimin aktual të biznesit,unë e inkurajoj dhe rekomandoj shoqërinë për të krijuar këtë strukturë.

Ajo është e vlefshme jo vetëm për përgatitjen e dhe paraqitjen me vërtetësi dhe sinqeritet të pasqyrave financiare ,por edhe për përzgjedhjen e politikave të përshtatshme kontabël apo kryerjen e vlerësimeve të arsyeshme në rrethanat konkretë.Me termin me vërtetësi dhe sinqeritet unë nuk nënkuptoj apo paragjykoj natyrën,shkallën e përshkurtimit apo karakterin individual të personave përgjegjës për përgatitjen e Pasqyrave Financiare,por nënkuptoj thjesht përgatitjen e pasqyrave në përputhje të plotë me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit .

Besueshmëria e informacionit financiar,trasaksionet ekonomike ,që unë kontrollova , janë të shoqëruara me dokumentacion justifikues,veprimet janë hedhur me shumat e sakta dhe në llogaritë e duhura,i përkasin shoqërisë dhe periudhës ushtrimore.Kuadrimet e llogarive janë kryer periodikisht dhe janë mbikqyrur nga drejtuesja e financës.Janë hartuar pasqyra financiare të ndërmjetme dhe i janë raportuar drejtimit në kohë optimale.

2. MBI KONTABILITETIN

- Kontabiliteti mbahet në përputhje me Ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare ” .Bilanci i llogarive dhe Pasqyrat financiare janë përpiluar në bazë të të drejtave të konstatuara e parime të tjera kontabël të parashikuar në legjislacionin shqiptar,si dhe në pajtim të plotë me Standartet Kombëtare të kontabilitetit.
- Mbajtja e kontabilitetit bëhet në mënyrën tradicionale në pasqyra të lidhura në program Exell,me rregjistrime në ditar,liber të madh,partitar.Sistemi kontabël është i përshtatshëm për hartimin e Pasqyrave Financiare .
- Rregullat dhe procedurat kontabël të verifikimit , dokumentimit dhe rregjistrimit , përpunimit dhe raportimit të trasaksioneve dhe ngjarjeve janë të përshtatshme
- Monedha raportuese është monedha kombetare e Shqiperise LEK-u.
- Plani i llogarive kontabël që përdor shoqëria siguron mbajtjen e kontabilitetit të përgjithshëm dhe analitik dhe në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit
- Mënyra e pasqyrimit të veprimeve ekonomike e financiare ,në dokumenta justifikues bazë dhe përmbledhës,është rregulluar në përshtatje me kërkesat ligjore.
- Hartimi dhe përpilimi i Pasqyrave financiare është kryer në vijimësi nga ana e specialistëve në fushën e kontabilitetit ,me profesionalizëm.

3. Mbi përshtatshmërinë e politikave kontabël.

Politikat kontabël janë përdorur në mënyrë të qëndrueshme nga shoqëria dhe nuk ka patur ndryshime as në ushtrimin 2011.

- Parimi bazë për përcaktimin e madhësisë së të ardhurave është parimi i konstatimit i kombinuar me atë të realizimit faktik të të ardhurave.
- Aktivitet Afatgjata Materiale (A.A.M) janë të vlerësuara me koston historike minus amortizimin i cili rëndon shpenzimet sipas normave të miratuara nga drejtimi dhe që ka marë parasysh normat amortizimit të përcaktuara në Ligjin mbi Tatimin mbi te Ardhurat si dhe kontributin dhe shkallën e përkushtimit të AAM-ve në kohë gjatë vitit kalendarik.
- Normat e amortizimit të përdorura janë
 - Ndërtesa 5 %
 - Galeri 5%
 - Ndërtime dhe instalime të përgjithshme 5%

- Makineri nën 20 vjete, vlera e mbetur 20%,
 - Mjete transporti (vlera e mbetur) 20%,
 - Inventar Ekonomik (vlera e mbetur) 20%
 - Paisjet informatike (vlera e mbetur) 25%;
- Shoqëria gjatë vitit nuk ka ndryshuar metodat e vlerësimit të aktiveve dhe pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve duke ruajtur parimin e vijimësisë.
 - Llogaritë vjetore janë përgatitur në strukturë dhe përmbajtje sipas parimeve të përgjithme dhe rregullave të përcaktuara ligjore.
 - Trasaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën kombetare duke përdorur kurset e këmbimit në datën e kryerjes të trasaksionit.
 - Vlerësimi i llogarive në monedha të huaja në datën e mbylljes të pasqyrave financiare, është kryer më kursin zyrtar të këmbimit valutor të Bankës të Shqipërisë;

1 Euro = 138.93 lekë

1 USD = 107.54 lekë

1GPB = 162.92 lekë

1CHF = 114.46 lek

4. Mbi trasaksionet dhe pohimet në Pasqyrat Financiare

Aktivet

Aktivet afat shkurtra;

Në datën 31.12.2011 shoqëria zotëronte aktive afat shkurtra në shumën 216.742.019 lekë të cilën e përbëjnë;

1. Aktive monetare në shumën 25.328.558 lekë dhe përfaqëson vlera në bankë dhe në para në dorë.

Vlerat në Pasqyrat Financiare, dokumentat e bankës dhe akt rakordimet vlerësohen të përshtatshme. Vlerat në valutë janë ndjekur me kursin e ditës.

Llogaritë bankare përputhen me rregjistrimet në kontabilitet. Vlerësimi i tyre është kryer me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2011.

2. Aktive të tjera financiarë afat shkurtër në shumën 166.528.606 lekë dhe përbëhen nga;

<u>Përshkrimi</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>31 Dhjetor 2010</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Kërkesa të arkëtueshme	18,321,502.00	24,839,892.00	-6,518,390.00
Kërkesa të tjera të arkëtueshme	137,099,805.00	702,087,696.00	-564,987,891.00
Instrumenta të tjera borxhi	11,107,302.00	11,103,302.00	4,000.00
<u>Totali</u>	<u>166,528,609.00</u>	<u>738,030,890.00</u>	<u>-571,502,281.00</u>

Klientë; për tu arkëtuar pas datës 31.12.2011, në shumën 18.321.502 lekë;

Debitorë të tjerë në shumën 137.099.805 lekë

Kërkesa të tjera të arkëtueshme në shumën prej 11.107.302 lekë

Shuma e llogarive analitike përputhet me llogarive sintetike të paraqitur në Pasqyrat Financiare.

3. Llogaritë Inventariale në shumën 24.884.853 lekë dhe përbëhen nga

Përshkrimi	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010	Ndryshimi +/-
Lëndët e para	42,327,246.00	48,185,454.00	-5,858,208.00
Produkte të gatshme	71,401,420.00	74,828,273.00	-3,426,853.00
Mallra për rishitje	28,633,850.00	0.00	28,633,850.00
Parapagesa për furnizim	-117,477,663.00		-117,477,663.00
Totali	24,884,853.00	123,013,727.00	-98,128,874.00

4. Aktive Afat gjata materiale në shumën 287.985.623 lekë dhe përbëhen nga;

Përshkrimi	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010	Ndryshimi +/-
Toka	68,335,634.00	68,335,634.00	0.00
Ndërtesa	43,033,586.00	87,272,231.00	-44,238,645.00
Makineri dhe paisje	119,306,384.00	182,365,635.00	-63,059,251.00
Aktive të tjera afatgjata	57,310,019.00	29,474,261.00	-248,078,996.00
Totali	287,985,623.00	367,447,761.00	-355,376,892.00

Njohja në Kontabilitet;

Aktivet e Afatgjata Materiale janë njohur në kontabilitet me koston e tyre Neto , që do të thotë Kosto historike minus amortizimin e tyre.

Amortizimi i tyre shpreh shkallën e përdorimit të aktivitetit dhe janë njohur si shpenzime sistematike përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit. Metoda e përdorur është ajo lineare brenda kufijve të parashikuar në legjislacionin fiskal për ndërtesat e galeritë, dhe me vlerën e mbetur për aktivitetet e tjera.

Aktivet e Afatgjata Materiale mbahen në kontabilitet të detajuar sipas emërimit, kohës kur ato janë vënë në efikasitet si dhe koston e blerjes së tyre të dhëna këto që janë në shërbim të drejtimit dhe janë pronë e shoqërisë.

4.1 Investime financiare Afatgjata, në shumën 4.910.329.00 lekë,

4.2 Aktive të tjera afatgjata jo materiale në shumën 3.984.058.464.00 lekë.

Totali i Aktivitetit është 4.493.696.435 lekë.

Pasivet dhe Kapitali

Pasivet-Detyrimet

5. Huatë dhe parapagimet,në shumën 1.172.156 lekë dhe përbëhet nga Të pagueshme ndaj Furnitorëve në shumën 922.987 lekë te cilët janë të analizuar në kontabilitet në mënyrë analitike Prapagime të arkëtuara në shumën 249.169 lekë,

<u>Përshkrimi</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>31 Dhjetor 2010</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Furnitorë	922,987.00	6,958,460.00	-6,035,473.00
Detyrime Tatimore	0.00	289,532,737.00	-289,532,737.00
Paradhënie të arkëtuara	249,169.00	287,083.00	-37,914.00
	0.00	0.00	0.00
<u>Totali</u>	<u>1,172,156.00</u>	<u>296,778,280.00</u>	<u>-295,606,124.00</u>

6. Detyrimet Afatgjata.

Detyrimet Afatgjata në shumën 467.819.875 si dhe detyrime ndaj konçensionarit në shumën 2.342.415.718 lekë; dhe përbëhen nga;

<u>Përshkrimi</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>31 Dhjetor 2010</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Hua dhe detyrime afatgjate	63,144,352.00	63,144,352.00	0.00
Hua të tjera Afatgjata	298,474,233.00	535,717,574.00	-237,243,341.00
Grande dhe të ardhura të shtyra	106,201,290.00	106,201,290.00	0.00
Konçensionari	2,342,415,718.00	2,342,415,718.00	0.00
<u>Totali</u>	<u>2,810,235,593.00</u>	<u>3,047,478,934.00</u>	<u>-237,243,341.00</u>

7. *Kapitalet*

Kapitali në shumë 1.406.373.932. lekë dhe përbëhet nga ;

<input type="checkbox"/> Kapitali themeltar në shumën	3.405.413.240 lekë
<input type="checkbox"/> Rezerva statuore	1.545.062.358 lekë
<input type="checkbox"/> Rezerva ligjore	39.410.111 lekë
<input type="checkbox"/> Rezerva të tjera	25.074.303 lekë

- Fitime,humbje,të mbartura -3.114.881.550 lekë
- Fitime,humbje,të ushtrimit - 217.789.776 lekë

Më poshtë është paraqitja e përbërsve të Kapitalit.

Përshkrimi	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010	Ndryshimi +/-
Kapitali Aksioner	3,405,413,240.00	3,405,413,240.00	0.00
Rezerva Statuore	1,545,062,358.00	1,545,062,358.00	0.00
Rezerva ligjore	39,410,111.00	39,410,111.00	0.00
Rezerva të tjera	25,074,303.00	25,074,303.00	0.00
Humbje të mbartura	-3,114,881,550.00	-3,114,881,550.00	0.00
Rezultati I ushtrimit	-217.789.776.00	0	-493,704,530.00
Totali	1,682,288,686.00	1,900,078,462.00	-493,704,530.00

Totali Detyrime dhe kapitali në shumën 4.493.696.435 lekë.

8. Mbi rezultatin e veprimtarisë

Fitime ,Humbje nga veprmtaria e shfrytëzimit	-105.325.189 lekë
Të ardhura dhe shpenzime financiare	-112.464.587 lekë
Rezultati i ushtrimit	-217.789.776 lekë

Më poshtë është paraqitja analitike e rubrikave të të ardhurave dhe të shpenzimeve si dhe rezultati i ushtrimit të krahasuar me një vit më parë.

Përshkrimi	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010	Ndryshimi +/-
Shitjet neto	13,205,311.00	9,320,917.00	3,884,394.00
Të ardhura të tjera	21,060,296.00	0.00	21,060,296.00
Ndryshimi I gjendjeve	0.00	2,100,000.00	-2,100,000.00
Totali i të Ardhurave	34,265,607.00	11,420,917.00	22,844,690.00
Materiale te konsumuara	-27,003,569.00	-25,263,480.00	1,740,089.00
Kosto e Punës	-22,198,467.00	-20,431,324	1,767,143.00
Shpenzime administrative	-2,569,805.00	-1,527,900.00	1,041,905.00
Amortizime dhe zhvlerësime	-87,818,955.00	-110,958,804	-23,139,849.00
Shpenzime financiare	-112,464,587.00	67,359,266	455,738,608.00
Totali i Shpenzimeve	-252,055,383.00	-90,822,242.00	-437,147,896.00
Rezultati ushtrimit	-217.789.776.00	-79,401,325.00	414,303,206.00

Të ardhurat,

Te ardhurat e kompanise jane te rregjistruara ne llogarite perkatese.Ato janë të analizuara dhe të barabarta me dokumentacionin dhe deklarimet përkatëse.

Shpenzimet

Shpenzimet jane te dokumentuara rregullisht dhe te evidentuara drejt ne llogarite perkatese, ato i shërbejnë efektivisht realizimit të të ardhurave të vitit ushtrimor

Pasqyrat shoqëruese;

Pasqyrat e fluksit të parasë,pasqyra e lëvizjeve në kapital dhe shënimet që shoqërojnë Pasqyrat Financiare janë plotësuar me të dhënat e kontabilitetit dhe japin shpegimet e nevojshme dhe të përshtatshme për përdoruesit e llogarive vjetore dhe respektojnë në formë dhe përmbajtje dispozitat rregulluese për to.

Ngjarjet pas mbylljes të bilancit

Nga vëshgimi i ngjarjeve pas mbylljes së bilancit nuk konstatohen trasaksione të përfshira në Pasqyrat financiare. që cënojnë vashdimësinë e shfrytëzimit dhe opinionin e raportit të auditimit

9. Vlerësime të përgjithshme

Në lidhje me Kapitalin në shënimin 7 të Pasqyrave Financiare,në vitin 2011,kapitalet e veta të shoqërisë janë ulur ndjeshëm në shifër absolute mbi 1.999 milionë lekë ose për 58.7% të kapitalit Aksioner.

Nga ana jonë ky fakt është shënuar në veçime që nuk e ndikojnë opinionin e këtij raporti

Në lidhje me shënimin 6 të Pasqyrave financiare,kemi paraqitur shumën e vlerës të Konçensionarit,pasi mendojmë se paraqitja e saj në Detyrimet Afatgjatë pasqyron më drejt natyrën e trasaksionit,se sa paraqitja e tyre si rubrikë më vete ,pas pjesës III.Kapitali.

10. Vlefshmëria dhe karakteri i letrës.

Kjo letër i drejtohet organeve drejtuese të shoqërisë “Albkromi” shoqëri në likuidim e sipër. dhe shërben vetëm për qëllimet e shprehura në kapitullin e parë të saj.

Letra ka karakter konfidencial dhe publikimi i saj apo paraqitja e saj nga ana Juaj në palë të treta e cënon këtë parim.
Është në gjykimin Tuaj nëse do ta përdorni ose jo në veprimtarinë e shoqërisë për përdoruesit e veçantë të Pasqyrave Financiare.

Ndërkohë, Të nderuar Zotërinj, mbetem i të gatshëm që të diskutojmë me ju mbi përmbajtjen e kësaj letrë si dhe me aspekte të tjera brenda kuadrit të angazhimit tonë në Auditimin e Pasqyrave Financiare të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur më 31.12.2011

AUDITUESIT E PAVARUR



Tiranë; MAJ, 2012



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SH.A. "ALBKROM" (Në Likuidim e Sipër)

TIRANË

KËSHILLI MBIKQYRËS

V E N D I M

Nr. 06 datë 28.05. 2012

Për

Miratimin e llogarive të vitit 2011.

Këshilli Mbikqyrës i Sh.A. Albkrom (Në Likuidim e Sipër) Tiranë, i mbledhur sot me datë 28.05. 2012, pasi shqyrtoj relacionin e paraqitur nga shoqëria "Mbi miratimin e llogarive vjetore 2011" sipas bilancit të hartuar nga shoqëria dhe të miratuar nga ekspertët kontabël të caktuar nga METE, mbështetur në nenin 130 të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare me Nr. 7638 date 19.11.1992" si dhe nenit 9, të Statutit të Shoqërisë,

V E N D O S I:

1.Miratimin e raportit të paraqitur nga ekspertët kontabël, dhe relacionin e Shoqërisë lidhur me rezultatet e vitit ushtrimor 2011 si me poshtë:

-Te ardhura	567.207.512 lekë
-Shpenzime	784.997288 lekë
-Humbja e vitit	217.789.776 lekë

Për Këshillin Mbikqyrës
KRYETARI
Stavri DHIMA